

NJOFTIM

Për kandidatët që do të testohen për pozicionin e punës:

Përgjegjës i Sektorit të Administrimit dhe Koordinimit të SRF Drejtorisë Teknike

Procedura: LËVIZJE PARALELE BRENDË SË NJËJTËS KATEGORI

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe VKM nr. 242, datë 18/03/2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese" i ndryshuar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), njofton se:

- **Znj. Lida Toska** do të vazhdojë konkurimin në procedurën e lëvizjes paralele brenda së njëjtës kategori.

Konkurimi:

- **Konkurimi -Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **13.07.2021** ora **12:00**.

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komiteti i Pranimit për Levizje Paralele (KPLP) i ngritur në AKEP**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- 40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnime dhe kualifikime në fushën përkatëse, si dhe 10 pike për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.
- 60 pikë** për intervistën e strukturuar me gojë.

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **Përgjegjës i Sektorit të Administrimit dhe Koordinimit të SRF**.

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 23, Kreu II të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese" i ndryshuar.

Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të njoftohet në datën **13.07.2021**.

Njoftimi fituesit do të publikohet: në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **19.07.2021**.

Njesia Përgjegjëse / Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)